



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2020:069681
Datë: 04.03.2024
Numri i dokumentit: 05403934

E.nr.1596/2022

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, gjyqtari Faton Ajvazi me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përbarimore të kreditorit Rr.S. nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson av Leutrim Ademi nga Mitrovica, kundër debitorit Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 04.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përbarimore në lëndën **E.nr.1596/2022**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.1596/2022, të datës 19.12.2022, e ka caktuar përbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit aktgjykimit C.nr.953/20, të datës 17.05.2021.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimet e datës 05.04.2023 dhe 04.03.2024, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës, që nga llogaria e debitorit, ta transferoj shumën e mjeteve prej 1,279.20 euro dhe 249.82 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e tij, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përbarimore në këtë çështje juridike përbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.1596/22, më datë 04.03.202

GJYQTARI
Faton Ajvazi